

AKT THEMELIMI

SHOQËRIA TREGTARE


“DLSOL”

SH.P.K

TIRANË / SHQIPËRI

DATË 04.02.2017

Sot, në Tiranë, më datë 04.02.2017 unë Z. Denion IDRIZI, i biri i Shpëtim dhe Enkela, lindur në Tiranë dhe me banim në Tiranë, me adresë banimi Rruga “Mihal Grameno”, Pallati Nr. 12/1, Ap.Nr. 7, i datëlindjes 07.08.1992, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, i identifikuar nëpërmjet pasaportës biometrike Nr. BC1003117 dhe Nr.Personal: J20807057A, lëshuar nga Ministria e Brendshme më datë 29.07.2010 dhe e vlefshme deri më datë 28.08.2020, hartoj aktin e themelimit të shoqërisë “DLSOL” SH.P.K. si më poshtë vijon bazuar në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” i ndryshuar, Ligjit Nr.131/2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”.



NENI 1 FORMA E SHOQËRISË

Formohet një shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (**SH.P.K.**), që ushtron aktivitetin e saj sipas objektit në përputhje me Legjislacionin Shqiptar në fuqi dhe në vecanti, por jo ekskluzivisht, me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" të ndryshuar, me ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" të ndryshuar, Ligjin Nr.131/2015 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit" si dhe me përaktimet e këtij statuti.

NENI 2 EMRI I SHOQËRISË

Emri i shoqërisë është "**DLSOL**" Sh.p.k.. Shoqëria mund të përdor edhe emërtimin e saj tregtar "**DLSOL**" Sh.p.k.. Shoqëria do të përdorë edhe vulën e saj në të gjitha korrespondecat dhe/ose në të gjitha dokumentet e saj e cila do të përbëhet minimalisht nga emri i shoqërisë dhe nga NIPT dhe nga çdo karakteristikë tjeter e nevojshme për shoqerinë.

NENI 3 ORTAKËT E SHOQËRISË

Shoqëria "**DLSOL**" Sh.p.k., krijohet dhe themelohet si shoqëri me përgjegjësi të kuftuar me 1 (një) ortak të vetëm. Ortaku i shoqërisë "**DLSOL**" Sh.p.k., është Z. Denion IDRIZI, i biri i Shpëtim dhe Enkela, lindur në Tiranë dhe me banim në Tiranë, me adresë banimi Rruga "Mihal Grameno", Pallati Nr. 12/1, Ap.Nr. 7, i datëlindjes 07.08.1992, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, i identifikuar nëpërmjet pasaportës biometrike Nr. BC10031117 dhe Nr.Personal: J20807057A, lëshuar nga Ministria e Brendshme më datë 29.07.2010 dhe e vlefshme deri më datë 28.08.2020, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar dhe me gjendje civile aktuale beqar. Shoqëria sipas vendimarrjes së ortakut të vetë të shoqërisë ose sipas vendimit të Asambles së Përgjithshme të Ortakëve dhe sipas irregullave/procedurave të këtij akt themeli, statutit të shoqërisë si dhe dispozitave ligjore në fuqi mund të bëhet shoqëri me më shumë se një ortak. Nëse shoqëria mbetet me një ortak, atëherë ortaku i vetëm detyrohet ta regjistrojë këtë fakt, sipas nenit 43 të ligjit Nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", të ndryshuar. Nëse ortaku i mbetur nuk përbush këtë detyrim, atëherë ortaku përgjigjet personalisht për detyrimet që shoqëria merr përsiper nga data në të cilën duhet të ishte kryer regjistrimi, sipas këtij nenit, deri në datën në të cilën ky regjistrim u krye efektivisht.

NENI 4 SELIA E SHOQËRISË

Selia e shoqërisë "**DLSOL**" Sh.p.k., ndodhet me adresë: "Tiranë, Rruga Ismail Qemali, Pallati Nr. 27/1, Shkalla Nr. 3, Kati 1 (parë)-rë". Trasferimi i selisë së shoqërisë "**DLSOL**" Sh.p.k. në një tjeter adresë bëhet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të ortakëve (ortakut të vetëm) dhe sipas procedurave ligjore dhe/ose nënligjore në fuqi për këtë qëllim duke bërë regjistrimin pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit si dhe duke bërë njoftimet e tjera sipas legjislacionit në fuqi (administratën tatimore qendrore dhe vendore). Shoqëria "**DLSOL**" Sh.p.k., mund të vendos të hapi brenda dhe jashtë vendit, degë dhe/ose zyra përsaqësimit sipas procedurave ligjore dhe/ose nënligjore në fuqi duke bërë regjistrimet e nevojshme sipas legjislacionit shqiptarë dhe/ose të huaj në fuqi për këtë qëllim.

NENI 5 OBJEKTI / VEPRIMTARIA TREGTARE E SHOQËRISË



Shoqëria "DLSOL" Sh.p.k., ka si objekt të veprimitarisë tregtare së saj, por pa u kufizuar, si vijon: "Veprimitari ndërtimore për ndërtim objektesh, rrugësh, ndërtim vepra arti rrugore dhe hekurudhore, ndërtime industriale, ndërtim ujsjellësa dhe kanalizime, ndërtim vepra kullimi, ujitje e impiante vaditëse, punime mbrojtëse dhe sistemim i hidraulikjyerje të brendshme dhe të jashtme, izolime, termoizolime akustike, veprimitari për karpentier dhe pajisje teknologjike në fusha të ndryshme, shfrytëzim i karierave të gurit për prodhim inerte, cemento, prodhim betonesh. Ndërtime e rikonstrukSIONE të infrastrukturës si dhe sistemit ujor, punime dhenu, sistemime, tarracime terrenesh, veshje me asfalto beton të rrugëve, ndërtime mbi shtresa si dhe sistemim asfalti sheshesh, veshje fasadash. Ndërtime qendrash e fshatash turistike, rivenie në punë të rikonstrukSIONE anijesh, sisteme të tokave huqësore dhe atyre që shërbejnë për ndërtime, etj. Studime, projektme, financime dhe menaxhimezbatim investimesh në turizëm, ndërtime civile, social-kulturore, industriale, ushtaraketregtare, banesa, infrastrukturë, rrugë, ura, kanalizime, ujsjellësa, parqe industriale, rikonstrukSIONE, restaurime, etj. Marrje veprash në koncesion nga qeveria për zhvillim aktiviteti prodhues, industrial, turizëm, transport, etj. Linja prödhimi e përpunimi industrial të lehtë dhe të rëndë, nxjerrje përpunimi mineralesh, eksport metalesh, lëndësh të para. Veprimitari prodhimi e konfeksionimi uji natyral e mineral. Aktivitete shërbimesh si pika servisi për riparime e 2 mjeteve motorrike të të gjitha llojeve, konsulencë teknike në projektim, gjetje dhe kryerje sponsorizimi të veprimitarive të ndryshme për vete apo për të tretë, aktivitete ndërmjetësimi mes palëve të intresuara për qëllim krijimin e raporteve me interes të ndërsjelltë, veprimitari financiare në të gjitha drejtimet, shërbime mirëmbajtje, supervizim punimesh, shërbime ndërmjetësimi për regjistrime dhe eregjistrime mjетesh, shërbime trasnporti mallrash apo pasagjerëve brenda dhe jashtë vendit. Demotime, shkatërrim mjethesh motorrike, ose jo, etj.. Veprimitari në fushën e botimeve dhe shtypshkrimeve etj". Për realizimin e objektit të veprimitarisë së saj, shoqëria "DLSOL" Sh.p.k., mund gjithashtu të blejë dhe të shesë pasuri të luajteshme dhe/ose të paluajteshme, të krycje çdo lloj operacioni finansiar aktiv e pasiv, të ndërmarrë e të zhillojë çdo lloj aktiviteti industrial, tregtar, që konsiderohen të dobisheme dhe të përshtatshme si dhe fitimprurëse për shoqërisë në përputhje me legjislacionin shqiptarë në fuqi dhe/ose me legjislacionin e huaj për këtë qëllim. Shoqëria "DLSOL" Sh.p.k., dhe sipas interesit të ortakut dhe/ose ortakëve të saj mund të ushtroje aktivitet tregtar fitimprurës të tjera nga ajo e përeaktuar në këtë nen, duke respektuar paraprakisht çdo kërkesë ligjore dhe/ose nënligjore në fuqi për këtë qëllim. Për aktivitet e përmendura më sipër shoqëria "DLSOL" Sh.p.k., (si dhe ato të papërmendura dhe të lejuara në bazë të legjislacionit në fuqi) mund ti kryej në sektorin publik, të administrimit publik në përgjithësi si dhe në sektorin privat. Aktivitete të tilla mund të kryhen nga shoqëria "DLSOL" Sh.p.k., si drejtpërdrejtë dhe nëpërmjet subjekteve të treta me qëllimet e dhëna, ose pjesëmarrëse ose të kontrolluar. Shoqëria "DLSOL" Sh.p.k., me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të ortakëve (ortakut të vetëm), në bazë të dispozitave të aktit të themelimit, statutit dhe në përputhje me ligjin/legjislacionin në fuqi, mund të marri drejtpërdrejtë ose indirekt interesa ose pjesëmarrje, duke përfshirë edhe ato aksionare, në shoqëri dhe/ose në ndërmarrje të ndryshme në Shqipëri dhe/ose në vende të tjera jashtë Shqipërisë, që kanë objekt të ngjashem, të njëjtë ose kanë lidhje me objektin e saj ose me qëllim fitimprurese për shoqërinë. Shoqëria "DLSOL" Sh.p.k. nuk kapër të kryer asnjë aktivitetë pa marrë paraprakish licencat e nevojshme sipas legjislacionit shqiptarë në fuqi apo legjislacionit të shteteve të huaja ku mund të ushtrojë aktivitetin e saj.

NENI 6 KOHËZGJATJA E SHOQËRISË



Kohëzgjatja e aktivitetit/veprimtarisë të shoqërisë “DLSOL” Sh.p.k., është e pakufizuar. Kohëzgjatja e aktivitetit/veprimtarisë të shoqërisë “DLSOL” Sh.p.k., fillon nga data e regjistrimi në regjistrin tregëtar të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (QKR) / Biznesit (QKB) dhe nëse kërkohet nga ligji mbas marrjes së licencave përkatëse për ushtrimin e aktivitetit tregtar.

NENI 7 KAPITALI I SHOQËRISË

Kapitali bazë filletar i shoqërisë “DLSOL” Sh.p.k., është 1.000 (njëmijë) lek dhe tërësish i paguar nga ortaku i vetëm i shoqërie sipas pjesmarjes në kapital e shoqërisë. Kontributi i ortakut/ëve përbëjnë kapitalin themeltarë dhe të regjistruar të shoqërisë “DLSOL” Sh.p.k. Kapitali shoqërisë “DLSOL” Sh.p.k., përbëhet nga 1 kuotë e cila ka vlerën / përfaqëson 100 % kapitalin e shoqërisë.

NENI 8 KONTRIBUTET NË KAPITALIN BAZË / FILLESTAR TË SHOQËRISË

Kapitali bazë përbëhet nga kontributi i ortakut/ëve si vijon: Z. Denion IDRIZI, kontribon 100 % duke zotuar 100 % kapitalin e shoqërisë “DLSOL” Sh.p.k., ose duke zotuar 100 % kuotën e vetme në kapitalin e shoqërisë “DLSOL” Sh.p.k. e cila përbën / përfaqëson 100 % kapitalin e shoqërisë. Shoqëria mund të lëshojë një çertifikatë e cila provon zotërimin e kuotave të kapitalit nga ortaku/ët e saj sipas dispozitave ligjore në fuqi për këtë qëllim. Administratori i hje sipas nevojës mund të marri vërtetim mbi statusin e kuotave të shoqërisë pranë Regjistrit të Barrave të Sigurimit (RBS) dhe/ose çdo institucion tjeter kompetent për këtë qëllim sipas dhe në përputhje me ligjin në fuqi për këtë qëllim. Çertifikata e lëshuar sipas pikës 2 të këtij nenit në emr të personit ose personave që zotërojnë kuotat në këtë shoqëri nuk mund të konsiderohet titull/letër me vlerë dhe/ose të vendoset si garanci. Të gjithë pjesët që formojnë kapitalin themeltar, nënshkruhen, shlyhen plotësisht, nga ortaku/ët e shoqërisë “DLSOL” Sh.p.k.

NENI 9 ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË

Organet e shoqërisë “DLSOL” Sh.p.k., janë si më poshtë vijon: Asambleja e Përgjithshme; Administratori/et.

NENI 10 ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

Shoqëria “DLSOL” Sh.p.k., administrohet nga administratori dhe ortaku i vetëm Z. Denion IDRIZI, i biri i Shpëtim dhe Enkela, lindur në Tiranë dhe me banim në Tiranë, me adresë banimi Rruga “Mihal Grameno”, Pallati Nr. 12/1, Ap.Nr. 7, i datëlindjes 07.08.1992, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, i identifikuar nëpërmjet pasaportës biometrike Nr. BC1003117 dhe Nr.Personal: J20807057A, lëshuar nga Ministria e Brendshme më datë 29.07.2010 dhe e vlefshme deri më datë 28.08.2020, dhe me gjendje civile aktuale beqar. Shoqëria mund të ketë më shumë se një administrator kur vendoset nga Ortaku i vetëm ose nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve të shoqërisë “DLSOL” Sh.p.k. dhe regjistrohet si i tillë pranë QKB. Shpërblimi i administratorit duhet të jetë i përshtatshëm dhe në përputhje me detyrat e administratorëve dhe gjendjen financiare të shoqërisë. Nëse shoqëria është në vështirësi financiare, Ortaku i vetëm ose Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve mund të vendosë reduktimin e shpërbllimit të dministratorëve në masën e përshtatshme. Ortaku i vetëm ose Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve mund të

shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Afati i emërimit, i cili caktohet në statut, nuk mund të jetë më i gjatë se 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje, me përjashtim të rasteve të dorëheqjes ose të pushimit të papritur. Administratori emerohet në këtë detyrë për një periudhë kohore 5 (pesë) vjeçare me të drejtë rizgjedhje. Kontrata e punës së administratorit dhe kur administratori është i ndryshëm nga ortaku i vetëm i shoqërisë duhet të miratohet nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve. Administratori ka të drejta dhe detyrime si më poshtë citohet në përputhje me ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe me këtë akt themelimi dhe/ose statut: kryen ië gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme; përsaqëson shoqërinë tregtare; kujdeset përmajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë; përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme përmiratim; krijojn një sistem paralajmërimi në kohën e duhur përrrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë; kryejn regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin përmiratim përrrethanat; raportojn përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare; kryerjen e detyrave të tjera që i caktohen nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim. Administratori është përgjegjës kundrjet shoqërisë ose të tretëve, si për shkelje të ligjit, ashtu edhe për shkelje të stautit ose përfajje të kryera gjatë administrimit të tij. Administratori mund të heqë dorë në çdo kohë nga detyra e tij, nëpërmjet një njoftimi me shkrim drejtuar Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve. Administratori, që jep dorëheqjen, duke pasur parasysh rrëthanat e veprimtarisë së shoqërisë, është gjithashtu i detyruar të thërrasë Asamblenë e Përgjithshme të Ortakëve përmiratim e administratorit të ri, përpara datës në të cilën doreheqja të hyje në fuqi. Nëse Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve nuk vendos emërimin e administratorit të ri në datën e përeaktuar në thirrjen e kryer nga administratori i dorëhequr, atëherë administratori i njofton me shkrim dorëheqjen Qëndrës Kombëtare të Regjistrimit, së bashku me kopjen e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme rë Ortakëve dhe Qëndra Kombëtare e Regjistrimit regjistron largimin e administratorit, sipas procedurave të ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007, "Per Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit", të ndryshuar. Dorëheqja e administratorit nuk cenon paditë e shoqërisë për shkelje të detyrimit të besnikërisë që administratori ka ndaj saj, sipas këtij ligji. Emërimi i administratorit/rëve të ri/rinjë, hyjn ne fuqi në datën e përeaktuar sipas aktit të emërimit, u kundrejtjohet palëve të treta sipas përeaktimit të nenit 12 të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar.

NENI 11 PËRFAQËSIMI I SHOQËRISË

Kufizimet e tagrave të përsaqësimit të administratorit/ëve i kundrejtosh palëve të treta, në përputhje me dispozitat e nenit 12 të ligji Nr. 9901, date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar. Administratori, që përsaqësonjë bashkërisht shoqërinë tregtare, mund të autorizojnë disa prej tyre për kryerjen e disa veprimeve të caktuara apo për kryerjen e disa kategorive të caktuara veprimesh. Përfaqësimi ligjor i shoqërisë (i drejtëperdrejte ose i deleguar



5

me autorizim) është i vlefshëm për çdo veprim gjyqësor apo jashtëgjyqësor. Veprimet e kryera nga përfaqësuesi ligjor i shoqërisë (i drejtëperdrejte ose i deleguar me autorizim) janë të detyrueshme për shoqërinë edhe nëse këto tejkalojnë objektin e saj, me përjashtim të rastit kur këto veprime shkojnë përtjej tagrave të përfaqësimit që u jep ligji apo lejon t'u jepen përfaqësuesve. Këto veprime nuk janë detyruese për shoqërinë nëse shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni se akti tejkalon objektin e saj, apo në bazë të rr Ethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të. Publikimi nëpërmjet ndryshimit të statutit nuk përbën provë të mjaftueshme për dijeninë e të tretëve, nëse ky ndryshim është bërë publik në mënyrë të ndryshme nga ato të parashikuara nga ligji për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Njoshtimet e drejtuara secilit prej administratorëve janë të vlefshme e detyruese për shoqërinë. Tagrat e përfaqësimit të administratorëve dhe çdo ndryshim i tyre njostohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit. Të gjitha shkresat, formularët e urdhvave apo çdo dokument tjeter korrespondencë, nxjerrë nga shoqëria, degët apo zyrat e përfaqësimit, nëpërmjet përdorimit të letrës ose mjeteve elektronike, të cilat u drejtohen palëve të treta, duhet të përbajnë të dhënët e mëposhtme: numrin unik të identifikimit; formën ligjore të shoqërisë; vendndodhjen e selisë së regjistruar dhe të zyrës qendrore të saj; të dhëna nëse shoqëria është në likuidim; Nëse shoqëria ka faqe interneti, këto të dhëna duhet të pasqyrohen aty.

NENI 12

Cdo gjë që tjetër dhe/ose më e detajuar parashikohet në statutin e shoqërisë, dhe/ose në legjislacionin shqiptarë në fuqi për këtë qëllim, kopje e të cilit do të depozitohet në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (Q.K.R) / Biznesit (Q.K.B) me qëllim jo vetëm regjistrimi.

THEMELUESI I SHOQËRISË “DLSOL” SH.P.K.

z. Denion Idrizi



(nënshtkrimi)

DATË 04.02.2017